



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me numër 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, për subvencionet në fushën e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Podujevës shpall:

FTESË PUBLIKE

PËR APLIKIM NË PROJEKTIN: PËRKRAHJE ME FIDANE DHE SISTEM TE UJITJES

- *Përkrahja e 10 fermerëve me fidane të feferonave dhe sistem të ujitjes me nga 1000 €*
- *Përkrahja e 10 fermerëve me fidane të somborkave dhe sistem të ujitjes me nga 1000 €*

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:

1. *Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës*
2. *Çertifikata e bashkësisë familjare*
3. *Vërtetimi i tatimit në pronë*
4. *Fletëposedimi (origjinal) për patundshmëri*
5. *Çertifikata e regjistrimit të fermerit-NIF. (të jetë i/e regjistruar si fermer para publikimit të thirrjes për aplikim).*

Përparësitë:

	<i>Poena</i>
1. Aplikuesit të cilët nuk kanë përfutuar në ndonjë projekt në 3 vitet e fundit	10
2. Aplikuesit gra	10
3. Fermerët të cilët janë kultivues të perimeve	5
4. Numri i antarëve të familjes (1-5 antarë- 5 pikë); (mbi 5 antarë -10 pikë)	
5. Vizita në terren	0-50

Sqarim:

- Furnizimi me fidane të feferonave dhe somborkave do të bëhet nga vet përfituesit, në etnitete që janë licencuar për prodhimin apo tregtimin e varieteteve të kërkuara;
- Mbjellja e fidaneve duhet të jetë sipas kritereve agroteknike, jo më pak se 6,000 fidane në 10 ari;
- Furnizimi me fidane të feferonave/somborkave dhe sistem të ujitjes do të bëhet nga vet fermerët përfitues;
- Përfituesit duhet të sjellin faturen e rregullt për blerjen e fidaneve të feferonave/somborkave dhe sistemit të ujitjes;
- Përfituesit e fidanëve të feferonave/somborkave dhe sistemit të ujitjes duhet të kenë burimin e ujit;
- Pjesa tjetër e investimit të bëhet nga vet fermerët
- Pagesa do të realizohet pas verifikimit nga organi kompetent komunal pasi të jenë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara ;
- Pas furnizimit me fidane të feferonave/somborkave dhe mbjelljes së tyre nga ana e përfituesit do të realizohet pagesa.

Koha dhe vendi i mbjelljes:

- Mbjellja e feferonave dhe somborkave duhet të bëhet në Pranverë.
- Kultivimi i feferonave dhe somborkave do të bëhet në territorin e Komunës së Podujevës.

VËREJTJE: FERMERËT MUND TË PËRFITOJNË VETËM NË NJËRËN NGA LLOJET E FIDANEVE ME SISTEM TË UJITJES TË LARTËCEKUR!

Aplikacionet (kërkesat) dorëzohen në Zyren e Shërbimit të Qytetarëve.

Afati i aplikimit është deri me datë 27.04.2026, në ora 16:00

Nr: 12-320/01-0019998/26

Podujevë
02.04.2026

